



THIRRJA E PARË E HAPUR PËR PROPOZIME PËR FONDIN E ARSIMIT TË INTEGRUAR

E hapur për:	Shkolla publike, kopshte, fakultete për trajnim për mësimdhënës/fakultete pedagogjike dhe komuna.
Mundësi financimi:	Deri në 7000 EUR për aplikim/thirrje ¹
Periudha e implementimit:	Qershor 2023 - Maj 2024
Afati i dorëzimit:	30 prill 2023

Udhëzime për aplikuesit për grante

Ndërtimi i urave të reja

Projekti “Ndërtimi i urave të reja” (NUR) ndërlidhet me Fondin për ndërtimin e urave të reja (NUR) për periudhën 2014-2021, i cili paraqiti një model për arsimin e integruar në Maqedoninë e Veriut duke mbështetur shkollat, komunat dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) për të bashkuar fëmijët me prejardhje dhe gjuhë të ndryshme përmes aktiviteteve të përbashkëta mësimore (kurikulare).

Ky projekt i ri synon më tej ndërtimin e shoqërive gjithëpërfshirëse që ushqejnë dhe krenohen me pluralizmin kulturor dhe respektin për tolerancën, dialogun dhe bashkëpunimin, në një klimë besimi dhe mirëkuptimi të ndërsjellë si garanci më të mira të paqes dhe sigurisë sociale.

NUR aktualisht mbështetet nga Mbretëria e Norvegjisë, Republika e Polonisë dhe Dukata e Madhe e Luksemburgut.

Objektivat e Fondit për Arsim të Integruar (FAI)

Objekti i përgjithshëm i **Fondit për Arsim të Integruar** është forcimi i marrëdhënieve ndëretnike dhe kohezionit social brenda mjediseve shkollore përmes rritjes së praktikave të integruara arsimore dhe shkëmbimeve ndërkulturore. Fondi synon të rrisë ndërveprimin ndëretnik, mirëkuptimin dhe integrimin midis fëmijëve dhe të rinjve duke motivuar dhe mbështetur financiarisht shkollat shumëgjuhëshe (filllore dhe të mesme), kopshtet dhe/ose shkollat/kopshtet e bashkuara njëgjuhësore, me gjuhë të ndryshme mësimore, si dhe institutet pedagogjike për të zbatuar aktivitete të përbashkëta kurrikulare dhe ekstra-kurrikulare.

¹ Në rastin e një komune që aplikon për grantin në emër të një konsorciumi shkollash (më shumë se dy), fondet e caktuara mund të rriten.

Objektivat specifike të **FAI** janë:

1. Forcimi i marrëdhënieve ndëretnike midis fëmijëve dhe të rinjve me prejardhje kulturore dhe gjuhësore të ndryshme përmes aktiviteteve të përbashkëta kurrikulare dhe ekstra-kurrikulare;
2. Inkurajimi i aktiviteteve që ofrojnë hapësirë për angazhim ndëretnik në përputhje me kurrikulat shkollore dhe udhëzimet ministrore;
3. Mbështetja e iniciativave të qëndrueshme që mund të përsëriten lehtësisht në të ardhmen.
4. Të vendoset respekt i ndërsjellë dhe të tejkalohen stereotipet dhe paragjykimet etnike;
5. Të zhvillojë ndjenjën e bashkësisë dhe përkatësisë përmes vlerave universale;

Sipas thirrjes së parë për propozime, Fondi për Ndërtimin e urave të reja siguron grante deri në 7000 Euro për shkollat, fakultetet pedagogjike dhe komunat, dhe deri në 3500 Euro për kopshtet, për propozim projektet e zbatuara midis qershorit 2023 dhe majit 2024.

Paketa e aplikimit

Paketa e aplikimit mund të shkarkohet përmes faqes së Misionit të OSBE-së në Shkup dhe faqes së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës [HYPERLINK] në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze. Aplikacionet duhet të dorëzohen në gjuhën angleze. Përveç versionit në gjuhë angleze mund të dorëzohet dhe version në gjuhën maqedonase dhe/ose shqipe. Afati i fundit për Thirrjen është **30 prill 2023**.

Aplikacionet mund të dërgohen direkt në: BNB.mk@osce.org

Mbështetje tutoriale: Ekipi i projektit Ndërtim i urave të reja ofron mbështetje teknike për të gjithë aplikantët në formën e tutorialeve gjatë periudhës së dorëzimit. Ju lutemi të paraqisni kërkesën tuaj për mbështetje teknike duke shkruar në adresën e mësipërme. Subjekti në email-in tuaj duhet të jetë "Nevojitet mbështetje teknike për aplikimin NUR". Emaili duhet të tregojë llojin e mbështetjes që kërkohet.

Procedura e vlerësimit: Aplikimet fillimisht shqyrtohen nga Zyra Ekzekutive e Fondit NUR për të përcaktuar nëse i plotësojnë kushtet. Së fundmi, një bord i pavarur këshillimor merr vendimin për ndarjen e fondit.

Për çdo pyetje në lidhje me thirrjen e hapur mund të kontaktoni ekipin tonë:

Nëse keni vështirësi në plotësimin e formularit pdf, mund të kërkoni formularin e aplikimit në një dokument word me email.

Emilija Simonovska | Tel: 070 358083

Florin Rexhepi | Tel: 070 358298

Email: bnb.mk@osce.org

Kriteret e pranueshmërisë

1. Pranueshmëria e aplikantit dhe partnerëve

Për t'u kualifikuar për një grant, **aplikanti duhet të jetë kopsht publik, shkollë, fakultet për trajnim të mësimdhënësve/fakultet pedagogjik ose komunë.**² Nëse aplikanti është një kopsht fëmijësh ose një shkollë me më shumë se një gjuhë mësimore, atëherë mund të aplikojë si një aplikant i vetëm, por duhet të përfshijë nxënës nga të paktën dy gjuhë mësimore nga ato që përdoren në shkollë. Nëse shkolla/kopshti i aplikantit është njëgjuhësore, në aplikim duhet të përfshihet të paktën një shkollë partnere me një/disa gjuhë të tjera mësimore. Nëse aplikanti është një fakultet për trajnim të mësimdhënësve, vlen i njëjti rregull – aplikimi duhet të përfshijë shkollat dhe/ose kopshtet me të paktën dy gjuhë të ndryshme mësimore dhe/ose një fakultet partner për trajnim të mësimdhënësve me të paktën një gjuhë të ndryshme mësimore.

Nëse financohet, në fillim të aktiviteteve të projektit, çdo përfituesi të grantit/kopshti/fakulteti për trajnim të mësimdhënësve do t'i kërkohet të kryejë një sondazhë bazë për të matur shkallën fillestare të kohezionit social midis djemve dhe vajzave që marrin pjesë. Më saktë, sondazhi ka për qëllim të masë perceptimet e përkatësisë, përfshirjes, tolerancës dhe pjesëmarrjes si fusha të rëndësishme të kohezionit social. Sondazhi do të zhvillohet nga Njësia NUR dhe do të realizohet më tej nga përfituesit e granteve si partnerë zbatues. Pjesëmarrësve do t'u garantohet fshehtësia e informacionit të dhënë në sondazhin. Të gjitha të dhënat do të ruhen dhe mirëmbahen në mënyrë të sigurt brenda serverit të Misionit. Gjetjet e sondazhit bazë do të futen në raportin përfundimtar të vetëvlerësimit të projektit

2. Pranueshmëria e aktiviteteve e projektit

2.1 Aktivitetet kurrikulare: Shkollat dhe Fakultetet për trajnim të mësimdhënësve/Fakultetet pedagogjike.

Orët e përbashkëta kurrikulare janë të detyrueshme për shkollat dhe fakultetet e trajnimit të mësimdhënësve sipas Fondit për Arsim të Integruar.

Shkollat dhe fakultetet e trajnimit të mësimdhënësve/fakultetet pedagogjike që aplikojnë në kuadër të kësaj Thirrje duhet të plotësojnë seksionet I, II, III, IV dhe VI, VII, VIII dhe IX të aplikimit. Ju lutem vini re se edhe pse seksioni V (aktivitetet ekstra-kurrikulare) është opsional për shkollat dhe fakultetet e trajnimit të mësimdhënësve, këshillohet fort që të përfshihen disa aktivitete plotësuese ekstra-kurrikulare si pjesë e aplikimit.

Fondi për Arsim të Integruar ka një fokus të veçantë në aktivitetet e përbashkëta kurrikulare midis fëmijëve me gjuhë të ndryshme mësimore dhe prejardhje të ndryshme etnike në përfundime me “Udhëzimet për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta kurrikulare” të krijuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.³ Implementimi i orëve të përbashkëta kurrikulare (p.sh., edukata fizike, gjuha angleze, shkenca ose çdo lëndë tjetër zgjedhore që mbështet zhvillimin emocional dhe social) duhet të synojë garantimin e vazhdimësisë dhe shpeshësisë së kontaktit midis të njëjtit grup nxënësish/studentësh gjatë dy semestrave, në bazë javore/dyjavore.

Duhet të sigurohet një përdorim fleksibil i gjuhëve gjatë gjithë realizimit të orëve të përbashkëta kurrikulare (dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare). Në përfundime me udhëzimet ministrore, gjatë realizimit të orëve të përbashkëta, mësimdhënësit inkurajohen të flasin në gjuhën e tyre amtare pa përkthim, dhe në vend të kësaj të parafranojnë

² Subjektet publiko-private inkurajohen gjithashtu të aplikojnë për grantin e AI.

³ https://mon.gov.mk/stored/document/Upatstvo%20za%20realizacija%20na%20zaednicki%20nastavni%20casovi_MKD_digit_alna%20verzija.pdf

informacionin përkatës në mënyrë që nxënësit të kenë mundësi të ndjekin mësimet në gjuhë të ndryshme dhe të ekspozohen ndaj gjuhës së Tjetrit.

Për këtë Thirrje, nxënësit pjesëmarrës në shkollë fillore duhet të jenë midis klasës së parë dhe të shtatë në kohën e aplikimit, ndërsa ata të shkollës së mesme/fakultetit në vitin e parë ose të dytë studimit. Sa u përket shkollave profesionale, nxënësit duhet të jenë në klasën e parë në kohën e aplikimit.

2.2 Aktivitete ekstra-kurrikulare: Kopshtet (e detyrueshme); shkollat/fakultetet e trajnimit të mësimdhënësve dhe komunat (opsionale)

Kopshtet që aplikojnë në kuadër të kësaj Thirrje duhet të plotësojnë vetëm seksionet I, II, III dhe V, VI, VII, VIII dhe IX të aplikimit.

Shkollat dhe fakultetet e trajnimit të mësimdhënësve rekomandohen fort që t'i plotësojnë aktivitetet e planifikuara të përbashkëta kurrikulare me një numër aktiviteteve ekstra-kurrikulare. Aktivitetet ekstra-kurrikulare duhet të arsyetohen qartë për atë se si mbështetin orët e përbashkëta kurrikulare. Aktivitetet ekstra-kurrikulare mund të përfshijnë klube debati dhe gara, përgatitjen e një buletini informativ të shkollës, performanca artistike.

Ju lutemi vini re se aktiviteteve ekstra-kurrikulare që përfshijnë prindër të nxënësve/studentëve të zgjedhur do t'u kushtohet vëmendje e veçantë.

Aktivitetet ekstra-kurrikulare gjithashtu mund të organizohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga një komunë aplikante për të promovuar projektin dhe shkollat pjesëmarrëse pa iu referuar një lënde specifike.

Propozim projektet gjithashtu duhet të sigurojnë që në bashkëkrijimin e aktiviteteve të përbashkëta kurrikulare dhe ekstrakurrikulare të jenë përfshirë mësimdhënës me gjuhë dhe përkatësi të ndryshme, dhe këto aktivitete të jenë "me të vërtetë" të përziera me:

- ✓ Përfaqësim të barabartë të fëmijëve me gjuhë të ndryshme mësimdhënëse të përfshirë në mënyrë bashkëpunuese drejt një objektivit të përbashkët gjatë aktiviteteve të përbashkëta kurrikulare.
- ✓ **Pjesëmarrje të barabartë të djemve dhe vajzave**, si dhe atyre **me nevoja të veçanta** dhe **prindërve/kujdestarëve aktivë**;
- ✓ **Përrjashtimi të çdo lloji diskursi politik gjatë aktiviteteve kurrikulare dhe ekstra-kurrikulare.**

3. Buxheti

Fondi **Ndërtimi i urave të reja nuk i paguan parat** por blen materialet dhe/ose shërbimet e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve sipas rregullave dhe procedurave të Misionit të OSBE-së në Shkup. Aplikanti duhet të japë një vlerësim të kostove të parashikuara, dhe pas kësaj Zyra Ekzekutive përfundimisht vendos për blerjet e pranueshme. Kërkesat për grante mund të përfshijnë tarifën e mësimdhënës/stafit për çdo aktivitet të kryer **pas** orëve të rregullta shkollore,⁴ shpenzimet e transportit, si dhe investimet materiale që janë të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të propozuara: Për shembull, propozimet projektet mund të përfshijnë rinovimin (p.sh., dysheme, ndriçim, tavolina të rrumbullakëta shkollore etj.) të një klase (të madhe) të dedikuar për aktivitete të përbashkëta kurrikulare dhe pajisje/materiale mësimore për t'u shërbyer të gjithë fëmijëve pjesëmarrës.

⁴ Bordi vlerëson aplikimet në të cilat mësimdhënësit dhe stafi janë të gatshëm të punojnë të paktën disa orë shtesë pa kompensim.

Projekti është një aktivitet i bashkëfinancuar, ku aplikanti mbulon shpenzimet për zyrat, shpenzimet komunale, ekspertizën e brendshme, etj. Shkalla e bashkëfinancimit që aplikanti do të jetë në gjendje të sigurojë do të jetë një nga kriteret në të cilat Projekti do të mbështetet gjatë vlerësimit të aplikantit/ëve.

4. Përfaqësuesi i nxënësve dhe konsultimet me nxënësit

Sa u përket aktiviteteve ekstra-kurrikulare, propozim projektet që përfshijnë përfaqësues të nxënësve nga grupet e përzgjedhura duhet të përfshihen drejtpërdrejt jo vetëm në procesin e identifikimit, por në hartimin e aktiviteteve dhe duke luajtur një rol aktiv në implementimin e tyre. Inputi i tyre në Raportin narrativ duhet siguar pas përfundimit të projektit. Qëllimi i kësaj kërkesë është për t'u siguar se të gjitha propozimet përfshijnë aktivitete të cilat vetë nxënësit i konsiderojnë si më të realizueshme dhe interesante, duke mbështetur kështu zhvillimin e një kulture të një rrjedhe të hapur idesh mes mësimdhënësve dhe nxënësve. Nëse një propozim projekti përfshin më shumë se një shkollë për aktivitete ekstra-kurrikulare, duhet të kenë të paktën një përfaqësues të nxënësve nga secila.

Përfshirja e përfaqësuesit të nxënësve nuk është një kusht për propozimet e kopshteve ose shkollave fillore, ku projekti do të përfshijë nxënës nga klasa e shtatë ose më poshtë. Aty ku është e mundur, aplikantët e tillë duhet të konsultohen me nxënësit gjatë hartimit të projektit. Vendimi se cili lloj i aktiviteteve të konsultimit do të funksionojë më së miri në një rast të veçantë i lihet aplikantit dhe shkollave partnere, duke pasur parasysh rrethanat specifike (si moshë e fëmijëve/nxënësve që do të marrin pjesë në projekt). Për të gjithë nxënësit, nën 18 vjeç, të përfshirë në aktivitetet e projektit, shkolla duhet të marrë miratimet e prindërve.

5. Njoftimi për vendimin

Aplikantët do të informohen me e-mail për vendimin e Bordit këshillues të fondit NUR në lidhje me aplikimin e tyre. Nëse aplikimi miratohet me kusht, aplikantët do të marrin komentet dhe rekomandimet e Bordit mbi atë se si ta rishikojnë aplikimin. Nëse kërkesa refuzohet, aplikanti do të marrë arsyetimin për vendimin negativ.

Aplikimet që janë më tepër në përputhje me objektivat e përcaktuara në këto Udhëzime, që kanë cilësinë më të lartë, ndikimin e pritur, qëndrueshmëri dhe efektivitet të kostos, do të kenë shans më të madh për të fituar grantin. Zyra Ekzekutive e Fondit NUR do të sigurojë mbështetjen e nevojshme për ndërtimin e kapaciteteve për mësimdhënësit, administratorët dhe nxënësit në formën e uebinareve dhe tutorialeve mbi menaxhimin e projekteve dhe praktikën e arsimit të integruar.

6. Bordi Këshillues i Fondit NUR

Bordi këshillues i Fondit të ri për NUR është organi kryesor që vlerëson aplikimet dhe organi vendimmarrës i gjithë skemës së financimit të NUR, detyra e të cilit është të vlerësojë propozim projektet dhe të marrë vendime për ndarjen e granteve. Parashikohet që Bordi të përbëhet nga Zëvendës Shefi i Misionit të OSBE-së në Shkup, Menaxheri i Projektit të NUR (Shefi i Departamentit të Dimensionit Njerëzor), Oficeri i Lartë për çështje gjinore (ose Zëvendës personi i kontaktit për çështje gjinore, ose një përfaqësues tjetër nga Njësia për çështje gjinore), Oficeri kombëtar i Programit përgjegjës për portofolin e arsimit, Oficeri i lartë i demokratizimit dhe një përfaqësues nga Njësia e monitorimit.

* * *



APLIKIMI I FONDIT PËR NDËRTIMIN E URAVE

FORMULARI I APLIKIMIT

Titulli i projektit			
Aplikanti			
Partnerët			
Seksioni I.D			
I.Profili i aplikantit⁵			
Adresa e shkollës			
Drejtori i shkollës, numri i telefonit dhe e-maili		Menaxheri i projektit, nr. i telefonit celular dhe e-maili	
Kopshti, shkolla fillore, shkolla e mesme ose fakulteti pedagogjik. Numri i ndërrimeve?		A janë ndërrimet e përziera? Përfaqësues i/të nxënësve	
Gjuha e mësimdhënies			
Aktivitetet ekzistuese dhe/ose të mëparshme të përbashkëta me partnerin/partnerët, nëse ka			
II Profili i Partnerit/ëve			
<i>[Nëse keni më shumë partnerë sesa hapësira më poshtë, ju lutemi mos ngurroni të shtoni më shumë kuti duke përdorur copy/paste. Nëse nuk keni partnerë, ju lutemi shpërfillni këtë seksion.]</i>			
Emri, adresa dhe komuna - partneri 1		Gjuha e mësimdhënies	
Kopshti, shkolla fillore, shkolla e mesme ose fakulteti pedagogjik. Numri i ndërrimeve?		A janë ndërrimet e përziera?	
Person kontakti partneri 1		Përfaqësues i/të nxënësve nga partneri 1	
		Shuma totale e fondeve të kërkuara	

⁵ Nëse kërkuesi është një komunë, në vend të emrit të Drejtorit, ju lutemi jepni emrin dhe kontaktin e zyrtarit përgjegjës. Si aplikues kryesor në emër të një konsorciumi të shkollave, komuna do të ketë përgjegjësi të përgjithshme në koordinimin/menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të përbashkëta të zbatuara nga shkollat.

III.a Përvoja e kaluar

Ju lutemi jepni një përmbledhje shumë të shkurtër, mundësisht në pika, të çdo aktiviteti të mëparshëm në fushën e arsimit të integruar/ndërkulturor të kryer nga shkolla juaj dhe partneri/ët (nëse ka).

III.b Rreth projektit

[Ju lutemi të jeni specifike kur adresoni nevojat, çështjet dhe grupet e synuara]

Përshkruani shkurtimisht mjedisin/situatën aktuale sociale dhe ndëretnike në shkollën/kopshtin/fakultetin pedagogjik tuaj. A ka një histori të dhunës ndëretnike në shkollën tuaj dhe/ose shkollën partnere? A po kërkonit të adresoni problemet e dhunës ndëretnike, gjuhës së urrejtjes, ngacmimit etnik dhe/ose diskriminimit gjatë këtij projekti?

III.c Kush është i përfshirë?					
[Ju lutemi, jepni detaje në lidhje me nxënësit që do të përfshihen drejtpërdrejt në zbatimin e projektit. Nëse keni më shumë partnerë/mësimdhënës të përfshirë sesa rreshtat më poshtë, futni rreshta shtesë. Nëse nuk keni partnerë, fshini rreshtat që nuk ju nevojiten.					
			Të dhënat sipas këtyre katër kolonave janë vetëm për nxënësit e përfshirë drejtpërdrejt		
Emri i aplikantit dhe partnerit/partnerëve	Numri i nxënësve në total	Numri i nxënësve	Klasa shkollore e nxënësve	Përfaqësimi gjinor	Përfaqësimi i gjuhëve të mësimdhënies
Emri i mësimdhënësve dhe stafit tjetër të përfshirë drejtpërdrejt në aktivitete	Tema	Pozita dhe emri i Institucionit arsimor	Numri i telefonit celular	E-mail	Gjuha e mësimdhënies
IV. Orët e përbashkëta kurrikulare: Shkollat dhe Fakultetet e trajnimit të mësimdhënësve.					
Shënim: Aktivitetet tuaja kurrikulare të propozuara duhet të jenë në përputhje me Udhëzimet për zhvillimin e orëve të përbashkëta mësimore.					
Sa shpesh planifikoni të kryeni aktivitete të përbashkëta në lëndën/ët e përzgjedhura (p.sh., çdo javë, çdo muaj)					
Sa është kohëzgjatja totale e aktiviteteve tuaja të përbashkëta të planifikuara?					
Ju lutemi jepni emrin e shkollës/ave në të cilën do të zhvillohet ora/ët e përbashkëta.					
Cilën klasë e synoni (p.sh. anglisht klasa e parë, matematikë klasa e tretë etj.)					
Ju lutemi përshkruani shkurtimisht mjedisin mësimor në të cilin do të zhvillohen orët e përbashkëta kurrikulare. Si do të siguroheni që mjediset e të mësuarit nuk shkaktojnë dëmtime fizike dhe psikosociale ndaj nxënësve dhe mësimdhënësve?					
(Për shkollat e bashkuara njëgjuhësore) Ju lutemi përshkruani shkurtimisht cilësinë e aksesit në ujë të pijshëm, shërbime sanitare dhe higjienë në shkollën tuaj dhe shkollën partnere.					

<p>(Për shkollat e bashkuara njëjshësore) Ju lutemi përshkruani shkurtimisht çdo çështje të sigurisë së transportit brenda dhe rreth shkollave partnere. A janë rrugët nga një shkollë në tjetrën dhe anasjelltas të sigurta? Cilat sfida i parashikoni në kalimin e nxënësve nga një shkollë në tjetrën për orët e përbashkëta kurrikulare?</p>	
<p>Ju lutemi jepni një përshkrim të shkurtër të përvojës së kaluar të mësimdhënësve të përzgjedhur në fushën e arsimit të integruar/ndërkulturor: A kanë pasur mësimdhënësit e përzgjedhur trajnim paraprak mënyrën se si të zhvillojnë orë të përbashkëta kurrikulare dhe/ose ndonjë lloj tjetër trajnimi ndërkulturor? A kanë mbajtur orë të përbashkëta kurrikulare në të kaluarën?</p>	
<p>Nëse mësimdhënësit nuk kanë bërë ndonjë trajnim paraprak, çfarë lloj trajnimi do t'u nevojitej?</p>	
<p>A flasin mësimdhënësit e përzgjedhur ndonjë gjuhë tjetër përveç gjuhës së tyre?</p>	
<p>Në cilat gjuhë do të ofrohen orët e përbashkëta kurrikulare të përzgjedhura?</p>	
<p>Ju lutemi përshkruani shkurtimisht qasjen pedagogjike ndaj mësimit për orët e përbashkëta kurrikulare (p.sh., konstruktivizëm/konstruktivizëm social, qasje tradicionale/bihejviorizëm). Nëse planifikoni të miratoni një qasje konstruktiviste në mësim, ju lutemi përshkruani shkurtimisht llojin e çdo aktiviteti bashkëpunues/pune në grup që keni ndërmend të përdorni (p.sh., luajtja e roleve, kuize, debate, etj.)</p>	
<p>Çfarë lloj materialesh mësimore (nëse ka) planifikoni të përdorni për klasat e përbashkëta të përzgjedhura? Për shembull, matematikë: artefakte matematikore, karta, ndihmesa vizuale, argjilë etj.</p>	
<p>Ju lutemi përmendni titujt e teksteve shkollore që do të përdorni si pjesë e orëve të përbashkëta.</p>	

<p>A keni në plan të përdorni ndonjë material tjetër të shtypur përveç teksteve shkollore? Ju lutemi jepni një përshkrim. Si do të siguroheshit që materialet mësimore shtesë janë gjithëpërfshirëse dhe të çliruara nga paragjykimet etnike dhe gjinore? Në cilat gjuhë do të sigurohen materiale mësimore shtesë?</p>	
<p>A planifikoni të përfshini aktivitete që zhvillojnë mësimin social dhe emocional (MSE) dhe/ose trajtojnë stresin potencial psikologjik dhe emocional dhe/ose përfshijnë tema që lidhen me edukimin mjedisor/parandalimin e konflikteve? Ju lutemi përshkruani shkurtimisht.</p>	
<p>V. Aktivitetet ekstra-kurrikulare: Kopshtet (e detyrueshme); shkollat/fakultetet e trajnimit të mësimdhënësve dhe komunitat (opsionale)</p>	
<p>Kopshtet që aplikojnë nën këtë Thirrje duhet të plotësojnë vetëm këtë seksion dhe jo seksionin IV. Aktivitetet ekstra-kurrikulare të implementuara nga kopshtet duhet të demonstrojnë vazhdimësinë dhe shpeshësinë e kontaktit (javor/dyjavor) midis nxënësve të përzgjedhur gjatë gjithë vitit kalendarik (shtator-maj).</p> <p>Sa u përket shkollave dhe fakulteteve të trajnimit të mësimdhënësve, qëllimi i këtyre aktiviteteve është të sigurojë hapësirë shtesë për nxënësit e angazhuar në orë të përbashkëta kurrikulare për të nxitur angazhimin qytetar dhe për të promovuar bashkëpunimin ndëretnik. Këto lloj aktiviteteve duhet të përfshijnë komunitetin më të gjerë siç janë prindërit e nxënësve (ose kujdestarët), anëtarët e komunitetit dhe/ose organizatat e shoqërisë civile. Aktivitetet ekstra-kurrikulare duhet të shfaqin një lidhje të ngushtë me orët e përbashkëta kurrikulare: Për shembull, nëse shkenca zgjidhet si një lëndë për orë të përbashkëta kurrikulare, aktivitetet ekstra-kurrikulare mund të përfshijnë organizimin e një hakatoni shkencor ose olimpiade në të cilën përfshihet komuniteti më i gjerë. Jini kreativë dhe përfshini nxënësit në planifikimin e këtyre aktiviteteve.</p> <p>Ju lutem vini re se një nga aktivitetet ekstra-kurrikulare duhet t'i përfshijë prindërit. Aktivitetet ekstra-kurrikulare gjithashtu duhet të shfaqin:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Përfaqësim të barabartë të fëmijëve me gjuhë të ndryshme mësimore të përfshirë në mënyrë bashkëpunuese drejt një objektivit të përbashkët gjatë aktiviteteve të përbashkëta kurrikulare. ✓ Pjesëmarrje të barabartë të djemve dhe vajzave, si dhe atyre me nevoja të veçanta dhe prindërve/kujdestarëve aktivë ; ✓ Përjashtim të çdo diskursi politik. <p>Aktivitetet ekstra-kurrikulare gjithashtu mund të organizohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga një komunë aplikante për të promovuar projektin dhe shkollat pjesëmarrëse pa iu referuar një subjekti specifik kurrikular.</p>	

V-a Plani i aktivitetit

Nëse keni më shumë aktivitete sesa hapësira më poshtë, shtoni më shumë hapësirë. Nëse keni më pak, fshini hapësirën që nuk ju nevojitet.]

Ju lutemi jepni një përshkrim të detajuar të aktivitetit që propozoni ta implementoni. Përpiquni t'u përgjigjeni gjashtë pyetjeve kryesore. Ju lutemi, përcaktoni sasinë e të dhënave dhe treguesit konkretë për t'u arritur:

- (i) Çfarë keni në plan të bëni?
- (ii) Kush është i përfshirë? Si do të siguroheni që aktiviteti juaj të promovojë cilësinë e ndërveprimit midis pjesëmarrësve dhe të nxisë integrimin kulturor?
- (iii) Kur planifikoni ta bëni këtë?
- (iv) Ku do të ndodhë?
- (v) Si planifikoni ta bëni?
- (vi) A planifikoni të përfshini aktivitete që zhvillojnë mësimin social dhe emocional (MSE) dhe/ose trajtojnë stresim potencial psikologjik dhe emocional dhe/ose përfshijnë tema që lidhen me edukimin mjedisor/parandalimin e konflikteve? Ju lutemi përshkruani shkurtimisht.

[Shkollat/fakultetet e trajnimit të mësimitdhënësve/komunitat: Ju lutemi jepni një përshkrim se si Përfaqësuesi/t e nxënësve do të përfshihen në zbatimin e aktivitetit, si dhe në ndjekjen e tyre.]

[Numri i përgjithshëm i nxënësve që do të përfshihen drejtpërdrejt në aktivitet; jepni të dhëna sipas gjinisë dhe gjuhëve të mësimitdhënies]

[Emri dhe titulli i personit përgjegjës për zbatimin e aktivitetit]

Emrat e mësimitdhënësve dhe/ose stafit tjetër të përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e aktiviteteve]

Përshkrimi i detajuar i Aktivitetit 2

Etj.

V-b. Kush është i përfshirë? (shkollat/fakultetet e trajnimit të mësimdhënësve: plotësoni vetëm këtë seksion nëse është ndryshe nga aktivitetet kurrikulare)

[Ju lutemi, jepni detaje në lidhje me nxënësit që do të përfshihen drejtpërdrejt në zbatimin e projektit. Nëse keni më shumë partnerë/mësimdhënës të përfshirë sesa rreshtat më poshtë, futni rreshta shtesë. Nëse nuk keni partnerë, fshini rreshtat që nuk ju nevojiten.]

Të dhënat në këto katër kolona janë vetëm për nxënësit drejtpërdrejt të përfshirë

Emri i aplikantit dhe partneri/ëve	Numri i nxënësve në total	Numri i nxënësve	Klasa shkollore e nxënësve	Përfaqësimi gjinor	Përfaqësimi i gjuhëve të mësimdhënies

Emri i mësimdhënësve dhe stafit tjetër të përfshirë drejtpërdrejt në aktivitete	Lloji i aktivitetit	Pozita dhe emri i Institucionit arsimor	Numri i telefonit celular	E-mail

VI. Kohëzgjatja

[Vendosni vetëm një "X" në fushën me muajin kur planifikoni të zbatoni aktivitetin.]

[Muajt numërohen sipas parashikimit të zbatimit të aktiviteteve në propozimin tuaj. Ju lutemi, ndryshoni numrin 1 në muajin përkatës (p.sh. mars, shtator, nëntor...) kur do të fillojnë aktivitetet dhe lini numrat e tjerë.]

Nëse keni më shumë aktivitete sesa kuti më poshtë, shtoni kuti të tjera. Nëse keni më pak, fshini kutitë që nuk ju nevojiten.]

Aktiviteti	Muaji												Lokacioni i implementimit të aktivitetit	
	Qershor 2023 (M1)	Korrik 2023 (M2)	Gusht 2023 (M3)	Shtator 2023 (M4)	Tetor 2023 (M5)	Nëntor 2023 (M6)	Dhjetor 2023 (M7)	Janar 2024 (M8)	Shkurt 2024 (M9)	Mars 2024 (M10)	Prill 2024 (M11)	Maj 2024 (M12)		

VII. Qëndrueshmëria

[Çfarë ndodh pas përfundimit të suksesshëm të aktiviteteve të projektit? Si do të veproni ju dhe partnerët tuaj me rezultatet e arritura? Si do të ndikojë ky projekt në avancimin e integritimit ndëretnik dhe të aktiviteteve të tilla përtej implementimit të projektit? Si do të shfrytëzohen donacionet e dhëna në mënyrë që të forcohet integritimi ndëretnik?]

[Tregoni qartë se si do të siguron vijimin e aktiviteteve të implementuara, si dhe se si do t'i vlerësoni ato.]

--

<p>Qëndrueshmëria financiare: Si do të financohen dhe/ose ndërtohen aktivitetet e ardhshme të integruara mbi rezultatet e këtij projekti pasi të përfundojë financimi i NUR?</p>
<p>Qëndrueshmëria institucionale: Çfarë lloj strukturash/mekanzmash për komunikim dhe bashkëpunim të ndërtuar si rezultat i fondit do të jenë në dispozicionin tuaj për të çuar më tej rezultatet e arritura pasi të ketë skaduar granti? Si do të përdoren këto mekanizma për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta në të ardhmen?</p>
<p>Qëndrueshmëria sociale: Si do të ushqehen dhe zhvillohen lidhjet e vendosura midis fëmijëve dhe /ose të rinjve në të ardhmen? Cili do të jetë roli i institucionit/organizatës përfituese të projektit në këtë veprim? Çfarë lloj aktiviteteve parashikoni të zbatoni në të ardhmen për të çuar më tej këto lidhje? A do të përdoren platformat e mediave sociale për komunikimin në vijim?</p>
<p>Sinergji me aktivitete të tjera: A planifikoni të bashkëfinanconi ose bashkoni këtë aktivitet me ndonjë projekt/program tjetër të shkollës suaj?</p>
<p>VIII. Dukshmëria</p> <p>Ju lutemi përshkruani se si do të siguron dukshmërinë e aktiviteteve të projektit (p.sh. postime në faqen e internetit të organizatës suaj, faqen e Facebook-ut, etj.). Specifikoni gjithashtu gjuhën/ët që do të përdorni për të siguruar dukshmërinë e aktiviteteve të projektit.</p>
<p>IX. Për çfarë keni nevojë?</p> <p>[Na tregoni se çfarë ju nevojitet. Mendoni për të gjitha gjërat që do t'ju nevojiten për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve. Mendoni për pajisjet, blerjet, shërbimet, tarifat, komisionet, transportin etj. Jini të detajuar dhe realistë. Mos lini asgjë jashtë, sepse nëse pika nuk është në buxhetin e kërkuar, ne nuk mund të sigurojmë fonde shtesë për të.]</p> <p>[Nëse keni më shumë linja buxhetore sesa linjat më poshtë, shtoni më shumë rreshta. Nëse keni më pak, fshini hapësirat që nuk ju nevojiten.] Lirisht shtoni rreshta për nën-pika poshtë çdo pike (psh. 3.1. Aktivitet vizatimi; 3.1.3. Shkumësa)]</p>

Pika	Njësia	Nr. i njësive	Kostoja për pikë	Kostoja totale
1. Burimet njerëzore				
Totali Burimet njerëzore				
2. Transporti				
Totali Transporti				
3. Aktivitetet⁷				
Totali Aktivitetet				
4. Pajisje				
Totali Pajisje				
5. Të tjera				
Totali Të tjera				
TOTALI			MKD	

⁶Në rast se kërkoni kompensim për mësimdhënësit/stafin, ju lutemi keni parasysh se **vetëm orët jashtë orarit të rregullt të punës do mund të mbulohen brenda këtij buxheti**. Njësia e kërkuar mund të paraqitet në orë ose në ditë (p.sh. nëse në ditë, numri i njësive është 0.25 (për një të katërtën e ditës së punës, atëherë është e barabartë me 2 orë), ndërsa kostoja për pikë është 500 denarë)

⁷ Ju lutemi, së pari listoni (nëse ka) aktivitetet kurrikulare në të njëjtën mënyrë si në IV. Kurrikulare pastaj aktivitetet ekstra-kurrikulare në të njëjtën mënyrë si në V. Aktivitetet jashtkurrikulare. Shtoni më shumë rreshta për të përfshirë çdo/të gjithë pikat që ju nevojiten. Materialet e nevojshme për zbatimin e secilit aktivitet duhet të deklarohen nën të (p.sh. për zbatimin e Aktivitetit 1 nën V. Vizitë në Operën dhe Baletin e Maqedonisë, ju duhet të përfshini kostot e transportit nën seksionin 2 ndërsa kostot e tjera si biletat e hyrjes, pijet freskuese, ushqimin etj. duhet të deklarohen si 3.1.1., 3.1.2., 3.1.3...).